



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
SEKRETARIA

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .04.2021

**MBLEDHJA Nr. 21,**  
**datë 22.04.2021, ora 11:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 22.04.2021, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 21 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 27, date 29.01.2021 “Mbi licencimin e shoqërisë “Ageta” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Borie – Lure 1” me kapacitet të instaluar 1800 kW”
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për rinovimin e licences nr. 343 seria F16 per furnizimin e energjise elektrike
3. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. nr. 241, datë 21.12.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “Hec Zall Xhuxhë” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Xhuxhë 1” me kapacitet të instaluar 3487 kW dhe Hec “Xhuxhë 2” me kapacitet të instaluar 1254 kW dhe me kapacitet total të instaluar 4741 kW” dhe një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 21.12.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “Hec Zall Xhuxhë” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”
4. Mbi miratimin e “Rregullave të përbashkëta të shlyerjes per shkëmbimin e energjisë në perputhje me nenet 50(3) dhe 51(1) të Komisionit Rregullator të Bashkimit European 2017/2195”
5. Mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me vendimin e ERE-s nr.60, datë 25.02.2021, “Mbi miratimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”
6. Çështje të tjera

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo

seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike. Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**